

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

## PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2014

### SESIONI I

E mërkurë, 18 qershor 2014

Ora 10.00

**Lënda: Histori baleti**

**Udhëzime për nxënësin**

Testi në total ka **20 pyetje**.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

**Për përdorim nga komisioni i vlerësimit**

|         |    |    |    |    |    |    |    |
|---------|----|----|----|----|----|----|----|
| Kërkesa | 1  | 2  | 3  | 4  | 5  | 6  | 7  |
| Pikët   |    |    |    |    |    |    |    |
| Kërkesa | 8  | 9  | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 |
| Pikët   |    |    |    |    |    |    |    |
| Kërkesa | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 |    |
| Pikët   |    |    |    |    |    |    |    |

Totali i pikëve

**KOMISIONI I VLERËSIMIT**

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Arti plastik lindi si pasojë e nevojës së njeriut: **1 pikë**
- A) për të shprehur një emocion
  - B) për të shprehur një dhimbje
  - C) për të kaluar kohën
  - D) për të gjitha këto
2. Zhan Zhorzh Noveri në vitin 1754 u ftua në Londër nga Gariku( aktor anglez me famë botërore). Kjo njohje shënoi një etapë të re në fatin dhe karrierën e tij. Ai kthehet në Lion si balet maestër i trupës, ku në shfaqjen e parë bën reformën duke i paraqitur Nimfat dhe faunët me kostume të lehta. Shfaqja e parë e kësaj trupe në Lion titullohej: **1 pikë**
- A) “Baleti kinez”
  - B) “Rekrutët prusianë”
  - C) “Gjuetari dhe vjelësit e rrushit”
  - D) “Tualeti i Venerës”
3. Elementet e Sistemit Klasik të kërcimit e kanë burimin që nga koha e: **1 pikë**
- A) lashtësisë
  - B) mesjetës
  - C) rilindjes
  - D) romantizmit
4. Atdheu i artit për Epokën e Rilindjes konsiderohet: **1 pikë**
- A) Franca
  - B) Rusia
  - C) Italia
  - D) Greqia
5. Në vitet 60- 70 të shekullit të XVIII, reformën më të rëndësishme në balet e bëri: **1 pikë**
- A) Salvadore Vigano
  - B) Zhan Zhorzh Nover
  - C) Fani Esler
  - D) Baltazar
6. Gjeni cila nga vallet e mëposhtme nuk i përket valles greke: **1 pikë**
- A) Vallet e epokës qytet-shtet
  - B) Kërcimet etruske
  - C) Vallet e epokës helenistike
  - D) Vallet arkaike
7. Sistemi i kërcimit oriental u përqendrua në: **1 pikë**
- A) Indi
  - B) Greqinë antike
  - C) Itali
  - D) Kinë

8. Baleti “Esmeralda” me motive nga Katedralja e Shën Mërisë së Hygoit , u vu në skenë nga: **1 pikë**

- A) Zhul Peroi
- B) Filip Talioni
- C) Salvadore Vigano
- D) Zhan Zhorzh Noveri

9. Njëri nga baletet e mëposhtme është balet me temë shoqërore: **1 pikë**

- A) Para stuhisë
- B) Shote Azem Galica
- C) Delina
- D) Partizani

10. Tema e baletit “Halili dhe Hajria” është: **1 pikë**

- A) Shoqërore
- B) Historike
- C) Bashkëkohore
- D) Luftë

11. Në vitin 1581 u krijua një gjini e re e baletit, përfaqësuar nga baleti me subjekt dramatik. Tregoni: **3 pikë**

- a) titullin e baletit: \_\_\_\_\_
- b) emrin e maestrit të këtij baleti: \_\_\_\_\_
- c) vendin ku u shfaq ky balet: \_\_\_\_\_

12. Në vitin 1661 u krijua në Francë Akademia e Dansit. Tregoni: **3 pikë**

- a) Çfarë studjohej në këtë akademi:  
\_\_\_\_\_
- b) Cila ishte brendia e shfaqjeve që organizoheshin në pallatet aristokrate?  
\_\_\_\_\_
- c) Cilët ishin interpretuesit artistikë të këtyre shfaqjeve:  
\_\_\_\_\_

13. Parimi bazë dhe më i rëndësishëm për kërcimin është hapja anësore e këmbëve. Listoni tre aftësi që fiton balerini/a nga ky pozicion: **3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_

14. Rendisni 3 nga pjesët përbërëse të baletit, si zhanër i artit të përbërë skenik. **3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_

- 15.** Listoni disa balete të koreografit Agron Aliaj: **3 pikë**
- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_
- 16.** Baletet “Liqeni i mjelmave”, “Bukuroshja e fjetur” dhe “Arrethyesja” ndikuan në zhvillimin e baletit në shumë vende të botës. Muzika e këtyre baleteve u kompozua nga Çajkovski. Kjo muzikë solli ndryshime të dukshme në artin e baletit. Listoni tre ndryshime: **3 pikë**
- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_
- 17.** Listoni tre emra artistësh të mëdhenj të baletit të periudhës së romantizmit. **3 pikë**
- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_
- 18.** Rendisni tre nga burimet që ne marrim njohuri mbi vallet ilire: **3 pikë**
- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_
- 19.** Shpjegoni termat: **3 pikë**
- a) Karakteristika muzikore të personazhit (leitmotiv):  
\_\_\_\_\_
- b) Sezonet ruse:  
\_\_\_\_\_
- c) Stil neo- klasik:  
\_\_\_\_\_
- 20.** Listoni tre nga grupet e para koreografike pas Luftës së Dytë Botërore në baletin shqiptar: **3 pikë**
- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_